



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI SPORTEVE I TIRANËS  
ADMINISTRATORI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2026

**FTESË PËR OFERTË**

**Nr. Datë .2026**

Për

**“Ekspertizë e jashtme për Asistencë Teknike nëzbatimin  
e projektit “TOURISFIT”, menaxhimin e komunikimit dhe planin e veprimit të  
përbashkët dhe udhërrefyesin”**

Financuar në kuadër të projektit “TOURISFIT”, programi “INTERREG IPA South Adriatic 2021-2027”

**DREJTUAR: TË GJITHË TË INTERESUARËVE PËR TË MARRË PJESË**

Publikuar në ëbsite-n e Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Referimi ynë:

Subjekti: Ftesë për ofertë me objekt “Kontratë Shërbimi për Asistencë Teknike, Menaxhim të Komunikimit dhe Mbështetje në Zbatimin e Projektit TOURISFIT ”

Të nderuar Zonja / Zotërinj,

Rektorati i Universitetit të Sporteve të Tiranës, në kuadër të zbatimit të projektit "TOURISFIT", financuar nga Programi Interreg IPA South Adriatic 2021–2027, në vijim të kërkesës së Drejtuesit të Projektit, përcjellë Administratorit me shkresën nr. 1048/7 Prot., datë 03.06.2026, si dhe në vijim të Urdhrit të Brendshëm nr. 66, datë 10.06.2026, ju fton të paraqisni ofertën tuaj me objekt: "Asistencë Teknike, Menaxhim të Komunikimit dhe Mbështetje në Zbatimin e Projektit TOURISFIT", sipas Termave të Referencës bashkëlidhur.

Kjo procedurë zhvillohet në përputhje me dispozitat e Rregullores (BE) 2021/1059 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 qershor 2021, mbi dispozitat specifike për objektivin European

**Territorial Cooperation (Interreg)**, të mbështetur nga **European Regional Development Fund (ERDF)** dhe instrumentet e financimit të jashtëm të Bashkimit Evropian, në lidhje me **Instrumentin e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA III)**, si dhe në përputhje me **Rregulloren (BE) 2021/1060**, që përcakton dispozitat e përbashkëta për fondet e menaxhuara nga Bashkimi Evropian. Procedura respekton gjithashtu rregullat e Programit **Interreg IPA South Adriatic 2021–2027, Subsidy Contract, Project Implementation Manual (PIM)** dhe **Practical Guide to Contract Procedures for European Union External Action (PRAG), versioni 2025**, për aq sa janë të zbatueshme për prokurimin dhe kontraktimin në kuadër të projektit.

### **Buxheti/Budget:**

Fondi limit i parashikuar është **2,526,048 (Dy milionë e pesëqind e njëzet e gjashtë mijë e dyzet e tetë) lekë pa tvsh.**

Nga kandidatët kërkohet që të bëjnë oferta teknike dhe financiare nën këtë buxhet maksimal.

### **Vendi dhe data e dorëzimit të ofertës:**

Aplikimet duhet të dorëzohen ekskluzivisht në autoritetin kontraktor në protokoll, në një zarf të mbyllur të vulosur dhe firmosur, në adresën:

Universiteti i Sporteve të Tiranës, Tiranë.  
Address: Rruga Muhamet Gjollesha 1001, Tiranë, Shqipëri

Afati i fundit i dorëzimit të ofertave do të jetë data **15.07.2026, deri në ora 16:00 pm.**

### **Kriteret e përjashtimit/ Exclusion criteria:**

Aplikuesit, duhet të vërtetojnë se përmbushin situatat e renditura më poshtë duke plotësuar formularin e vetdeklarimit mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme ligjore bashkëlidhur kësaj ftese (shtojca 2):

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse” .
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv) në rastin kur është person fizik/shpk,
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale,
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

- *Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*

### **Kriteret e përzgjedhjes/Selection criteria:**

Operatorët ekonomik **duhet të dorëzojë në një zarf të mbyllur të vulosur/firmosur, me protokoll pranë autoritetit kontraktor, jo me vonë se data dhe ora e caktuar**, plotësimin e dokumentave si më poshtë (dhe sipas shtojcave bashkëlidhur):

1. Formulari i ofertes financiare, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur.
2. Formulari i vetdeklarimit sipas shtojcës 2 bashkëlidhur.
3. Oferta teknike (Organizimi dhe metodologjia) sipas shtojcës 3 bashkëlidhur

4. CV e ekspertit
5. Kontrata të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, ku totali i tyre të jetë me vlerë jo më të vogël se 40 % fondi limit.

**Dokumentat e mësipërme duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre e të përkthyer. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Kërkesat minimale të kualifikimit:

- Diplomë universitare; Master përbën avantazh.
- Të paktën 5 vite eksperiencë në menaxhim projektesh, komunikim dhe koordinim.
- Eksperiencë në projekte Interreg/IPA ose programe të financuara nga BE përbën avantazh.
- Eksperiencë në organizimin e aktiviteteve, hartimin e raporteve dhe materialeve të komunikimit.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

**Shënim:** *Autoriteti Kontraktor në zbatim të ligjit Nr. 87/2019 “Per faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, do pranojë të likujdojë vetëm fatura elektronike për shërbimin e marrë.*

**Kriteri i vlerësimit /Aëard criteria:**

Çdo aplikant duhet të paraqesë ofertën në një zarf të vetëm të mbyllur, të vulosur.

Oferta fituese do të përzgjidhet sipas raportit më të mirë cilësi–çmim: 80% vlerësim teknik dhe 20% vlerësim financiar.

Aplikanti fitues do të ftohet për lidhjen e kontratës.

**Kohëzgjatja e kontratës/ Duration of contract:**

Periudha e zbatimit: nga nënshkrimi i kontratës deri në përfundim të projektit (parashikuar deri në dhjetor 2027).

**Nënkontraktimi / outsourcing:**

Nënkontraktimi nuk është i lejuar.

**Gjuha e tenderit / Tender language:**

Oferta e tenderit dorëzohet në shqip. Dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Ofertat e tenderit të paraqitura në ndonjë gjuhë tjetër do të refuzohen automatikisht.

Draft Formulari i kontratës është bashkëlidhur.

**Komisioni**

**Elona Mehmet**

**Holtion Orhani**

**Gleni Marku**

**ADMINISTRATORI  
HAXHIRETE SULAJ**

**Shtojca 1**

[ Shtojca për t'u plotësuar nga Aplikanti]

Datë / /2026

**FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**

Emri i Aplikantit: \_\_\_\_\_

Për: **Universitetin e Tiranës**

Projekt i financuar në kuadër të projektit “**TOURISFIT**”, “**INTERREG IPA South Adriatic 2021-2027**”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Ekspertizë e jashtme për Asistencë Teknike nëzbatimin e projektit “TOURISFIT”, menaxhimin e komunikimit dhe planin e veprimit të përbashkët dhe udhërrefyesin**”

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës është \_\_\_\_\_ (vlera në shifra dhe fjalë) **lekë pa TVSh;**

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi lekë (pa tvsh)	Vlera lekë (pa tvsh)
1	Produkti 1 sic kerkuar ne TOR	totale	1		
2	Produkti 2 sic kerkuar ne TOR	totale	1		
3	Produkti 3 sic kerkuar ne TOR	totale	1		
4	.....				
	<b>Çmimi Neto (lekë pa tvsh)</b>				
	<b>TVSH (%)</b>				
	<b>Çmimi Total (lekë me tvsh)</b>				

**Emri, Mbiemri** \_\_\_\_\_

**Firma** \_\_\_\_\_

**Vula** \_\_\_\_\_

**Data e dorëzimit** \_\_\_\_\_

## Shtojca 2

(Shtojcë për tu paraqitur nga Aplikanti)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e Administrtorit të \_\_\_\_\_, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN E SHERBIMIT

Identifikimi	Përgjigja
Emri i Aplikantit:	-----
Numri ID / NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

#### Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

##### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Aplikanti nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Aplikanti nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Aplikanti nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv) në rastin kur është person fizik/shpk. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Aplikanti deklaron se plotëson të gjitha termat e references/specifikimet, siç udhëzohet në ftesë, dhe merr përsipër të realizojë objektin në përputhje me to.

## B: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie. Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

**Emri, Mbiemri** \_\_\_\_\_

**Firma** \_\_\_\_\_

**Vula** \_\_\_\_\_

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

### Shtojca 3

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Kontraktuesi ]

#### TERMAT E REFERENCES

**“Ekspertizë e jashtme për Asistencë Teknike nëzbatimin  
e projektit “TOURISFIT”, menaxhimin e komunikimit dhe planin e veprimit të  
përbashkët dhe udhërrefyesin”**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

#### SHTOJCA III: TERMAT E REFERENCËS

**Ekspert për Asistencë Teknike, Komunikim dhe Mbështetje në Zbatim të Projektit  
“TOURISFIT” në kuadër të Programit INTERREG IPA South Adriatic 2021-2027**

##### **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

- 1.1. Vendi partner
- 1.2. Autoriteti kontraktor
- 1.3. Sfondi i vendit
- 1.4. Situata aktuale në sektor
- 1.5. Programet e lidhura dhe aktivitetet e tjera të donatorëve

##### **2. OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E PRITSHME**

- 2.1. Objektivi i përgjithshëm
- 2.2. Objektivi/Objektivat specifik(e)
- 2.3. Rezultatet e pritshme që duhet të arrihen nga kontraktori

##### **3. SUPOZIMET DHE RREZIQET**

- 3.1. Supozimet mbi të cilat bazohet projekti
- 3.2. Rreziqet

##### **4. FUSHA E PUNËS**

- 4.1. Të përgjithshme
- 4.2. Puna specifike
- 4.3. Menaxhimi i projektit

##### **5. LOGJISTIKA DHE AFATET KOHORE**

- 5.1. Vendndodhja
- 5.2. Data e fillimit dhe periudha e zbatimit të detyrave

##### **6. KËRKESAT**

- 6.1. Stafit
- 6.2. Ambientet e zyrës

6.3. Facilitetet që do të sigurohen nga kontraktori

6.4. Pajisjet

7. **RAPORTET**

7.1. Kërkesat për raportim

7.2. Dorëzimi dhe miratimi i raporteve

8. **MONITORIMI DHE VLERËSIMI**

8.1. Përcaktimi i treguesve

8.2. Kërkesa të veçanta

## **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

### **1.1. Vendi Partner**

Shqipëria

### **1.2. Autoriteti Kontraktor**

Universiteti i Sporteve të Tiranës, Shqipëri

### **1.3. Sfondi i Vendit**

Shqipëria merr pjesë në mënyrë aktive në disa programe të bashkëpunimit territorial në kuadër të IPA III 2021–2027, përfshirë Programin Interreg IPA South Adriatic, i cili promovon bashkëpunimin ndërkufitar dhe zhvillimin e qëndrueshëm rajonal ndërmjet vendeve partnere në zonën e Adriatikut Jugor.

Projekti TOURISFIT synon të forcojë turizmin sportiv inovativ dhe të qëndrueshëm në rajonin e Adriatikut Jugor përmes bashkëpunimit ndërkufitar, duke promovuar rritjen ekonomike, përfshirjen sociale, stilet aktive të jetesës dhe shkëmbimin kulturor përmes iniciativave sportive dhe të sporteve elektronike (e-sport).

Projekti kontribuon në forcimin e bashkëpunimit rajonal përmes:

- zhvillimit të ofertave inovative të turizmit sportiv;
- angazhimit të palëve të interesit dhe planifikimit me pjesëmarrje;
- zbatimit të iniciativave pilot në fushën e turizmit sportiv;
- forcimit të kapaciteteve përmes trajnimeve dhe rrjetëzimit;
- si dhe zhvillimit të një Plani të Përbashkët Veprimi dhe një Udhërrëfyesi për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit sportiv në zonën e Adriatikut Jugor.

Universiteti i Sporteve merr pjesë në projekt si Partner Projekti 6 (P6), përgjegjës për aktivitetet në Shqipëri që lidhen me angazhimin e palëve të interesit, zbatimin e aktiviteteve pilot, aktivitetet e komunikimit, zbatimin e trajnimeve dhe kontributin në Planin e Përbashkët të Veprimit.

### **1.4. Situata Aktuale në Sektor**

Turizmi sportiv përfaqëson një sektor në zhvillim me potencial të konsiderueshëm për zhvillim në Shqipëri dhe në rajonin më të gjerë të Adriatikut Jugor. Pavarësisht interesit në rritje për turizmin aktiv, rekreacionin në natyrë dhe sportet elektronike (e-sport), sektori vazhdon të përballlet me sfida që lidhen me:

- koordinimin e kufizuar ndërmjet palëve të interesit;
- mungesën e të dhënave të mjaftueshme dhe hartëzimit të aseteve të turizmit sportiv;
- integrimin e dobët ndërmjet sektorëve të turizmit dhe sportit;
- përdorimin e kufizuar të mjeteve dixhitale dhe planifikimit të bazuar në të dhëna;
- si dhe bashkëpunimin e pamjaftueshëm rajonal dhe promovimin e përbashkët.

Projekti TOURISFIT synon t'i adresojë këto sfida përmes një qasjeje të koordinuar dhe të bazuar në evidenca, duke kombinuar hartëzimin, angazhimin e palëve të interesit, aktivitetet pilot, komunikimin dhe planifikimin strategjik.

Projekti është në përputhje me:

- prioritetet e Programit Interreg IPA South Adriatic;
- politikat e Bashkimit Europian për turizmin e qëndrueshëm dhe zhvillimin rajonal;
- objektivat e EUSAIR;
- prioritetet e tranzicionit të gjelbër dhe dixhital;
- si dhe iniciativat që promovojnë stile aktive të jetesës, angazhimin e të rinjve dhe inovacionin në turizëm.

## **2. OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E PRITSHME**

### **2.1. Objektivi i Përgjithshëm**

Objektivi i përgjithshëm i kësaj detyre është të ofrojë asistencë teknike, mbështetje për zbatimin e projektit, menaxhim të komunikimit dhe mbështetje për koordinimin e palëve të interesit për Universitetin e Sporteve / PP6, me qëllim zbatimin efektiv të projektit TOURISFIT.

### **2.2. Objektivat Specifike**

Eksperti do të kontribuojë në arritjen e objektivave specifike të projektit duke:

- mbështetur zbatimin dhe koordinimin e aktiviteteve të projektit nga këndvështrimi menaxherial, financiar, teknik dhe administrativ;
- koordinuar aktivitetet e komunikimit, shpërndarjes së rezultateve, vizibilitetit dhe angazhimit të palëve të interesit të PP6;
- mbështetur zhvillimin e Planit të Përbashkët të Veprimit dhe Udhërrëfyesit për turizmin sportiv të qëndrueshëm në Shqipëri dhe në rajonin e Adriatikut Jugor;
- siguruar koordinimin dhe komunikimin me partnerët e projektit dhe grupet e synuara të interesit.

### **2.3. Rezultatet e Pritshme që Duhet të Arrijë Kontraktori**

Rezultatet e pritshme të kësaj kontrate janë si më poshtë:

1. Ofrimi i mbështetjes teknike dhe menaxheriale për zbatimin e aktiviteteve të projektit nga PP6;
2. Kontribut në aktivitetet e hartëzimit, analizës së palëve të interesit dhe mbledhjes së të dhënave për turizmin sportiv;
3. Organizimi dhe lehtësimi i aktiviteteve pjesëmarrëse, takimeve dhe workshopeve;
4. Koordinimi dhe zbatimi i aktiviteteve të komunikimit dhe shpërndarjes së rezultateve;
5. Kontribut në zhvillimin e Planit të Përbashkët të Veprimit dhe Udhërrëfyesit.
6. Përgatitja e raporteve, përditësimeve të progresit dhe dokumentacionit teknik;
7. Koordinimi me partnerët e projektit dhe palët e interesit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit.

## **3. SUPOZIMET DHE RREZIQET**

### **3.1. Supozimet mbi të cilat bazohet projekti**

- Partnerët e projektit ruajnë bashkëpunim dhe komunikim efektiv;
- Institucionet përkatëse mbështesin zbatimin e aktiviteteve të projektit.

### **3.2. Rreziqet**

- Ekziston një rrezik i mundshëm i vonesave në zbatimin e aktiviteteve për shkak të situatave specifike politike në vendet partnere.
- Ekziston një rrezik i mundshëm i vonesave në koordinimin e aktiviteteve me partnerët e projektit.

## **4. FUSHA E PUNËS**

### **4.1. Të Përgjithshme**

#### **4.1.1. Përshkrimi i Detyrës**

Kjo detyrë synon të ofrojë asistencë teknike dhe mbështetje në komunikim për Universitetin e Sporteve në cilësinë e Partnerit të Projektit 6 (PP6) në projektin TOURISFIT. Eksperti do të mbështesë zbatimin e projektit nga perspektiva menaxheriale, financiare, teknike, e komunikimit dhe organizative.

Eksperti do të kontribuojë në:

- zbatimin e Paketave të Punës 1, 2 dhe 3;
- koordinimin e aktiviteteve të komunikimit dhe shpërndarjes së rezultateve;
- organizimin dhe lehtësimin e aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesit dhe grupeve të punës;
- si dhe mbështetjen për bashkëhartimin e Planit të Përbashkët të Veprimit dhe Udhërrëfyesit.

Eksperti do të mbështesë përgatitjen e raporteve, prezantimeve, dokumentacionit të angazhimit të palëve të interesit dhe dokumentacionit të zbatimit të projektit.

#### **4.1.2. Zona Gjeografike që do të Mbulohet**

Shqipëria

#### **4.1.3. Grupet e Synuara**

Përfituesit e projektit.

## **.2. Puna Specifike**

Ekspertiza e jashtme do të:

1. Mbështesë PP6 në zbatimin e projektit nga perspektiva menaxheriale, financiare, teknike dhe administrative;
2. Koordinojë aktivitetet e komunikimit dhe shpërndarjes së rezultateve të PP6;
3. Mbështesë zbatimin e Planit të Komunikimit dhe aktiviteteve të vizibilitetit;
4. Përgatisë produkte komunikimi, duke përfshirë:
  - komunikata për shtyp;
  - artikuj informues;

- prezantime;
  - përmbajtje për rrjetet sociale;
5. Mbështesë organizimin dhe lehtësimin e aktiviteteve me pjesëmarrje dhe takimeve me palët e interesit;
  6. Mbështesë aktivitetet e hartëzimit dhe analizës së palëve të interesit në kuadër të WP1;
  7. Mbështesë mbledhjen e të dhënave dhe raportimin në lidhje me iniciativat e turizmit sportiv dhe vendndodhjet e turizmit sportiv;
  8. Mbështesë organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve pilot në Shqipëri;
  9. Mbështesë zbatimin e aktiviteteve trajnuese dhe tryezave të punës;
  10. Mbështesë organizimin dhe lehtësimin e grupeve të punës në kuadër të WP3;
  11. Kontribuojë në hartimin dhe koordinimin e Planit të Përbashkët të Veprimit dhe Udhërrëfyesit për Shqipërinë;
  12. Koordinojë komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit me partnerët e projektit dhe palët e interesit;
  13. Përgatisë kontribute teknike, raporte, përmbledhje aktiviteteve, procesverbale takimesh dhe përditësime të progresit;
  14. Sigurojë përputhshmërinë me kërkesat e Interreg IPA për vizibilitetin dhe raportimin.

#### **4.1.4. Institucioni Përgjegjës**

Universiteti i Sporteve

#### **4.1.5. Struktura e Menaxhimit**

Universiteti i Sporteve është Partneri i Projektit 6 (PP6) në projektin TOURISFIT dhe është përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të projektit në Shqipëri, në koordinim me Partnerin Udhëheqës (Lead Partner) dhe partnerët e tjerë të projektit.

#### **4.1.6. Facilitetet që do të Sigurohen nga Autoriteti Kontraktor dhe/ose Palë të Tjera**

Universiteti i Sporteve do të sigurojë:

- hapësirë zyre, kur është e nevojshme;
- mbështetje për koordinimin;
- akses në dokumentacionin e projektit;
- si dhe komunikim me partnerët e projektit.

## **5. LOGJISTIKA DHE AFATET KOHORE**

### **5.1. Vendndodhja**

Universiteti i Sporteve, Tiranë

### **5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Zbatimit të Detyrave**

Data e parashikuar e fillimit është 1 gusht 2026 dhe periudha e zbatimit do të vazhdojë deri në përfundim të projektit, në dhjetor 2027 (17 muaj).

## **6. KËRKESAT**

## **Eksperti**

- Diplomë universitare në administrim publik, administrim biznesi, menaxhim sportiv, ekonomi, shkenca sociale ose një fushë tjetër të ngjashme.
- Diplomë pasuniversitare (Master) në fushat e mësipërme konsiderohet avantazh.
- Të paktën pesë (5) vite përvojë profesionale relevante në:
  - menaxhim projektesh;
  - komunikim dhe shpërndarje të rezultateve;
  - koordinim të konsultimeve me shumë aktorë;
  - organizim workshopesh dhe aktiviteteve pjesëmarrëse.
- Përvoja në programet Interreg, IPA ose programe të tjera të bashkëpunimit territorial të financuara nga Bashkimi Europian konsiderohet një avantazh i rëndësishëm.
- Përvojë në aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit në përputhje me kërkesat e Bashkimit Europian.
- Përvojë në koordinimin e palëve të interesit dhe organizimin e proceseve pjesëmarrëse.
- Përvojë në hartimin e raporteve, materialeve të komunikimit dhe dokumentacionit të projekteve.
- Njohja e rrjedhshme e gjuhës angleze, me shkrim dhe me gojë, është e detyrueshme. Njohja e gjuhëve të tjera përbën avantazh.
- Aftësi të forta organizative dhe koordinuese në menaxhimin e projekteve, me aftësi për të menaxhuar afatet kohore, udhëhequr proceset dhe për të dorëzuar rezultate cilësore nën presion.

### **6.1.1. Ekspertët Kryesorë**

N/A (Nuk aplikohet)

### **6.1.2. Ekspertë të Tjerë, Staf Mbështetës dhe Backstopping**

N/A (Nuk aplikohet)

## **6.2. Ambientet e Zyrës**

Ambientet e zyrës për ekspertin që punon në kuadër të kësaj kontrate do të sigurohen nga Universiteti i Sporteve, kur të jetë e nevojshme.

## **6.4. Pajisjet**

Nuk do të blihet asnjë pajisje në emër të autoritetit kontraktor/vendit partner si pjesë e kësaj kontrate shërbimi dhe as nuk do t'i transferohet autoritetit kontraktor/vendit partner në përfundim të kontratës. Çdo pajisje që lidhet me këtë kontratë dhe që duhet të blihet nga vendi partner, do të prokurohet përmes një procedure të veçantë tenderimi për furnizime.

## **7. RAPORTET**

### **7.1. Kërkesat për Raportim**

Raporti i aktivitetit duhet të përgatitet sipas afateve kohore të përcaktuara në kontratë. Raporti narrativ duhet të përgatitet dhe të dorëzohet së bashku me faturën përkatëse.

### **7.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve**

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet personit përgjegjës për miratimin e raporteve.

## **8. MONITORIMI DHE VLERËSIMI**

### **8.1. Përcaktimi i Treguesve**

Monitorimi do të kryhet nga Universiteti i Sporteve bazuar në produktet dhe rezultatet e dakordësuara (deliverables).

### **8.2. Kërkesa të Veçanta**

N/A (Nuk aplikohet).

## **KONTRATË SHERBIMI (DRAFT FORMULARI I KONTRATËS)**

Lidhur midis palëve të mëposhtme:

Autoriteti Kontraktor: UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS, përfaqësuar nga Administratori, Z. Haxhirete SULAJ, me adresë Rruga Muhamet Gjollësja 1001, Tiranë 1001, Tiranë, me Nipt \_\_\_\_\_, nga njera anë,

dhe

Kontraktuesi: “.....”, përfaqësuar nga Administratori, Z/Zj....., me adresë ....., me NIPT ....., nga ana tjetër.

### **Neni 1: Subjekti i kontratës**

Subjekti i kontratës është ekspertizë e jashtme për Asistencë Teknike në zbatimin e projektit “TOURISFIT”, menaxhimin e komunikimit dhe planin e veprimit të përbashkët dhe udhërrefyesin në Tiranë, Albania.

Kontraktuesi do të ekzekutojë detyrat që i janë caktuar në përputhje me Termat e References bashkangjitur kontratës (Aneksi II).

### **Neni 2: Vlera e kontratës**

Kjo kontratë, e shprehur në Lekë, është një kontratë me çmim global.

Vlera totale e kontratës për zbatim është: (...) **lekë pa TVSh** dhe (...) sipas ofertës së paraqitur (Annex IV).

**Taksat sipas ligjit në fuqi do të paguhet nga kontraktuesi sipas ligjit në fuqi për personat fizik.**

Eksperti do të paguhet sipas produkteve të përcaktuara në paketën e punës :

- Para-pagim – 30 % të vlerës së kontratës ose pas firmosjes së kontratës dhe dorëzimit të planit të aktiviteteve ....
- Pagesa e parë e ndërmjetme – 30 % e kontratës bruto pas dorëzimit të faturës dhe raportit narrativ me produktet respective sipas termave të referencës
- Pagesa e dytë e ndërmjetme – 30 % e kontratës bruto pas dorëzimit të faturës dhe raportit narrativ me produktet respective sipas termave të referencës
- Pagesa finale – 10 % e kontratës ose ALL bruto pas dorëzimit të faturës dhe raportit të progresit përfundimtar me produktet e kontratës

Fonde shtesë dhe aktivitete mund të shtohen tek kjo kontratë , me marrëveshje të përbashkët dhe adendum në një fazë të mëvonshme.

### **Neni 3: Dokumentet kontraktuese**

Dokumentet që bëjnë pjesë në këtë kontratë janë (sipas rendit të përparësisë):

- Kontrata (Annex I);
- Termat e References (Annex II)
- CV e ekspertit (ANNEX III)
- Oferta financiare (ANNEX IV)

#### **Neni 4: Dispozita të përgjithshme**

Kontraktuesi do të ekzekutojë kontratën me kujdesin e duhur, efikasitetin dhe përkushtimin në përputhje me praktikën më të mirë profesionale.

Detyrimet e përgjithshme të Aplikantit janë të përcaktuara në Termat e References/Specifikimet Teknike (Aneksi II), që i bashkëlidhet kësaj kontrate.

#### **Neni 5: Shërbimi dhe pagesat**

Kontraktuesi do t'i lëshojë UST fatura(t) për të dhënë shërbimet, pas pranimit dhe miratimit të Produkteve të paraqitura.

Tarifat për shërbimet e kryera dhe shpenzimet e duhura do t'i paguhet Kontraktuesit brenda 30 ditëve nga marrja e faturave dhe dokumentave mbështetës.

Pagesat (duke përjashtuar çdo tarifë bankare) do të bëhen në LEK në llogarinë bankare të Kontraktorit siç specifikohet më poshtë:

Emri Bankës :	
Adresa Bankës:	
Emri i Llogarisë:	
IBAN	

#### **Neni 6: Kohëzgjatja e kontratës**

Kjo kontratë do të fillojë në datën ..... dhe do të përfundojë me përfundimin e suksesshëm të punës së përshkruar, por jo më vonë se data ..... në bazë të përmbushjes dhe performancës së detyrave dhe përgjegjësisë, të parashikuara në këtë kontratë sipas Aneksit 1.

#### **Neni 7: Penalitetet e kontratës**

Ofruesi i shërbimit do të garantojë çdo punë të kryer sipas këtij afati të përcaktuar në këtë kontratë.

Ofruesi i shërbimit mban përgjegjësi personale dhe merr përsipër të dëmshpërblejë UST, në rast se me veprimet ose mosveprimet e tij shkakton humbje, dëme, shpenzime për Autoritetin Kontraktor ose palë të treta.

#### **Neni 8: Anulimi i kontratës**

Kontrata mund të pezullohet nga Kontraktuesi për një nga arsyet e mëposhtme:

- Autoriteti Kontraktues nuk përmbush pagesën dhe detyrimet e tjera.

Kontrata mund të përfundojë nga Autoriteti Kontraktues për një nga arsyet e mëposhtme:

- Kontraktuesi është në shkëlqim serioze të kontratës, duke mos përmbushur detyrimet kontraktuale.
- Kontraktuesi është i falimentuar ose po përfundon, po administron çështjet e tij nga gjykatat, ka hyrë në aranzhime me kreditorët, ka pezulluar aktivitetet e biznesit, është subjekt i procedimeve në lidhje me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që vjen nga një situatë e ngjashme të parashikuara në legjislacionin ose rregulloret kombëtare.

**Neni 9: Gjuha e kontratës**

- Gjuha e kontratës dhe e të gjitha komunikimeve me shkrim ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor dhe/ose menaxherit të projektit do të jetë shqip.

**Neni 10: Kushte të tjera specifike që zbatohen për kontratën**

- Nuk zbatohen kushte të tjera specifike për kontratën

**Neni 11: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që lind ose lidhet me këtë Kontratë, e cila nuk mund të zgjidhet ndryshe, do t'i referohet juridiksionit ekskluziv të Gjykatës së Rrethit Tiranë, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Përpiluar në gjuhën shqipe dhe angleze në 4 (katër) kopje origjinale për secilën, tre origjinale janë për autoritetin kontraktues dhe një origjinal është për kontraktuesin.

**Për Kontraktuesin****Emri:****Titulli:****Nënshkrimi:****Data:****Për Autoritetin Kontraktues****Emri:** Haxhirete Sulaj**Titulli:** Administrator**Nënshkrimi:****Data:**